



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RREGULLORE

*“Mbi ndalimin e pirjes së duhanit në mjediset e punës
të Institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*

(miratuar me Vendimin nr. 9, datë 25/01/2016)

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9636, datë 06.1.2006 “*Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit*”, i ndryshuar, dhe në kuadër të zbatimit të masave për parandalimin e pasojave të dëmshme në shëndetin e njeriut nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre, harton rregulloren me përmbajtjen si më poshtë,

Neni 1

1. Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha mjediset e punës ku ushtrojnë veprimtarinë dhe detyrat e tyre punonjësit e institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si:

- a) zyra;
- b) salla mbledhjesh;
- c) korridore;
- d) magazina;
- e) dhoma tualeti;
- f) shkallë;
- g) ashensorë;
- h) automjete;
- i) mjedise të tjera të përbashkëta të qarkullimit brenda godinës.

2. Në mjediset e brendshme të institucionit vendosen në vend të dukshëm lista e trupave inspektuese për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, si dhe shenja paralajmëruese me përmasa 40 cm² me mbishkrimin “NDALOHET PIRJA E DUHANIT”, të cilat janë të lexueshme nga një largësi prej 5m.

Neni 2

Për punonjësit të cilët konsumojnë duhan, caktohet vend i posaçëm jashtë mjediseve të punës, që përdoret ekskluzivisht si vendi ku mund të konsumohet duhani.

Neni 3

Ndaj punonjësve, të cilët identifikohen duke konsumuar duhan në vendet e përcaktuara në nenin 1, pika 1, të kësaj rregulloreje, ndërmerren masa disiplinore në zbatim të nenit 15, pika 1, gërma a, të ligjit nr. 9636, datë 06.1.2006 “*Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit*”, i ndryshuar.

Neni 4

Me qëllim zbatimin rigoroz të ligjit anti-duhan dhe kësaj rregullore, çdo punonjës që identifikon persona, të cilët konsumojnë duhan brenda mjediseve të punës së institucionit të KMSHC-së, kanë detyrimin të lajmërojnë menjëherë personin përgjegjës, në mënyrë që të merren masat e nevojshme.

Neni 5

1. Personi përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje është Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
2. Personi përgjegjës përgjigjet për vendosjen e shenjave të dukshme që informojnë se ndalohet pirja e duhanit në mjediset e KMSHC-së, listën e trupave inspektuese për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, si dhe heqjen dhe moslejimin e tavllave/taketukeve të duhanit brenda mjediseve të institucionit.
3. Personi përgjegjës, në rast se konstaton apo vihet në dijeni të faktit se punonjësit e KMSHC-së, janë duke, ose kanë konsumuar duhan në mjediset e ndaluara, sipas përcaktimit në nenin 1.1. të kësaj rregulloreje, informon menjëherë eprorin direkt të punonjësit dhe merr masat për procedimin disiplinor të tij në përputhje me përcaktimet e rregullores së brendshme *“Për organizimin dhe funksionimin e sekretaritit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*.

Neni 6

Në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, publikohet në vend të dukshëm, logo në mbështetje të nismës *“Shqipëria Jo Duhanit”*, si dhe një mesazh informues për ndikimin e duhanpirjes në shëndet dhe rreziqet nga përdorimi i produkteve të duhanit. Për përmbushjen e këtij detyrimi ngarkohet specialisti i Teknologjisë së Informacionit (IT).

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA